



KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DŽAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Gjakovë - Džakovica - Gjakova

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2019

Datë: 25.07.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 9 të rendit të ditës: Propozim- Vendim për themelimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale- kiosqeve , e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale –kiosqeve, me këtë përbërje :
 1. z. Flamur Fetahaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 2. z. Arben Bakalli, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 3. znj. Teuta Pallaska Milla, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
 4. znj. Dafina Syla, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
 5. z. Idriz Daci, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që të zhvilloj procedurat e parapara me Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale vetëm për pronat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi Kiosqet, për të cilat është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
 - Anëtareve të Komisioni .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton

